

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6255  
E enjte, 4 mars 2021  
çmimi 0.40 €

Shtohen rastet me Covid  
në Kosovë, 568 raste  
të reja për 24 orë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

LIDERI I LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI, KA SHPREHUR OPTIMIZËM  
PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA | FAQE 4-5

## KURTI: I KEMI VOTAT PËR QEVERINË E RE

### OPINION

DIPLOMACIA SHQIPTARE,  
MIDIS EUROPIANIZMIT E  
SOVRANIZMIT, LARG MODELIT  
'SUI GENERIS EVROPIAN' | F. 10-11

Prof. Lisen  
BASHKURTI



### AKTUALE

KOMUNA E PODUJEVËS  
KUNDËRSHTON NDËRTIMIN  
E HIDROCENTRALIT NË LUMIN  
KAÇANDOLLI | F. 8

MË 5 MARS MBAHET MANIFESTIMI  
'EPOPEJA E UÇK-së' | F. 7



### EKONOMI



AUDITORI I PËRGJITHSHËM  
VIZITON TURQINË, MERR  
MBËSHTETJE NGA PRESIDENTI I  
EUROSAI-t | F. 9

PRITET RITJJA  
E ÇMIMEVE TË DERIVATEVE  
TË NAFTËS NË KOSOVË | F. 9

### SPORT

KRASNIQI: FERONIKELI NUK E KA  
PROBLEM ÇËSHTJEN E PAGAVE | F. 12

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kandidat për kryeministër, Albin Kurti, është shprehur i bindur se i ka votat për formimin e qeverisë së re. Në Tiranë ai ka thënë se do t'i ketë më shumë se 61 deputetë për t'u bërë kryeministër i Kosovës dhe nuk ka nevojë për votat e partive të tjera. Kurti ka deklaruar se edhe Vjosa Osmani, aleatja e tij politike, do të bëhet presidente e vendit pa bërë asnjë kompromis



## KQZ-ja SOT SHPALL REZULTATIN PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE | FAQE 3

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) sot (e enjte) pritet ta shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të 14 shkurtit. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar se rezultati përfundimtar do t'i përfshijë rezultatet për të gjitha subjektet politike dhe kandidatët pjesëmarrës në zgjedhje



**FREEDOM HOUSE:**  
SHQIPËRIA DHE  
KOSOVA, PJSËRISHT  
TË LIRA | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Bideni premton vaksina për të gjithë deri në fund të majit

WASHINGTON, 3 MARS - Shtetet e Bashkuara deri në fund të majit do të kenë vaksina të mjaftueshme kundër koronavirusit, për secilin të rritur, tha presidenti amerikan Joe Biden. Ai tha se vaksinimi duhet të zgjerohet dhe njerëzit të binden për t'u vaksinuar. "Kemi nevojë për vaksinues, njerëz që i vendosin vaksinat në krahët e njerëzve, në krahët e miliona amerikanëve", tha Biden. Ai, po ashtu, paralajmëroi se njerëzit duhet "të mbeten vigjilentë" sepse, siç tha, "kjo luftë është larg përfundimit". Shtetet e Bashkuara janë vendi më i prekur në botë nga koronavirusi. Mbi 28 milionë njerëz janë infektuar atje dhe mbi 516 000

kanë vdekur.

Që nga fillimi i vitit ka pasur rënie të ndjeshme të rasteve të konfirmuara në ditë: nga 300 000, sa ka qenë kulmi më 8 janar, shifra tani sillet në rreth 68 000 në ditë.

Megjithatë, kjo rënie është zvogëluar gjatë javës së kaluar, çfarë ka nxitur frikë për një vale tjetër.

Në ShBA janë dhënë mbi 76 milionë doza të vaksinave, që kanë mbuluar rreth 15.3 për qind të popullatës. Këtë javë autoritetet shëndetësore kanë miratuar për përdorim edhe vaksinën e tretë "Johnson & Johnson". Dy vaksinat e tjera që përdoren në ShBA janë "Pfizer/BioNTech" dhe "Moderna".



## Partia e Orbanit largohet nga grupi i EPP-së



BUDAPEST, 3 MARS - Partia në pushtet në Hungari, Fidesz, është tërhequr nga Partitë Popullore Evropiane (EPP) në Parlamentin Evropian, pasi grupi konservator miratoi rregulla të reja të brendshme. Kryeministri hungarez, Viktor Orbán njoftoi për këtë vendim, përmes një letre dërguar kryetarit të Grupit parlamentar të EPP-së, Manfred Weber, letër të cilën e postoi në "Twitter" një nga ministrat e tij.

Ky vendim vjen një ditë pasi EPP-ja ndryshoi rregullat e saja të brendshme, për të lejuar që

të përjashtohen partitë politike dhe jo vetëm anëtarët e një partie, një ndryshim ky që u pa si një mundësi për të përjashtuar partinë Fidesz nga grupi më i madh parlamentar në Parlamentin Evropian. "Ndryshimet në rregullat e grupit të EPP-së, qartësisht janë një veprim armiqësor ndaj Fidesz dhe votuesve tanë... Kjo është anti-demokratike, e padrejtë dhe e papranueshme", ka shkruar Orbán në letrën drejtuar Weberit.

Grupi i EPP-së, ku bëjnë pjesë edhe konservatorët e

kancelares gjermane, Angela Merkel, ka pasur grindje të vazhdueshme me Fideszin për vite me radhë.

Fidesz, parti e krahut të djathtë, ka dy të tretat e deputetëve në Parlamentin hungarez dhe është në pushtet që nga viti 2010. Kjo parti që prej vitit 2018 është suspenduar nga EPP-ja, por kishte ende ligjvënës në këtë grup parlamentar. Për një kohë të gjatë, BE-ja e ka akuzuar Orbánin se po minon liritë demokratike, mediat dhe organizatat joqeveritare si dhe sundimin e ligjit.

## Qantas prezanton "fluturimet misterioze"

CANBERRA, 3 MARS - Kompania e fluturimeve Qantas do të prezantojë "fluturimet misterioze", teksa bën përpjekje të rrisë turizmin e brendshëm në gjithë Australinë. Udhëtimet ditore, në të cilat pasagjerët nuk e dinë se ku do të shkojnë, kanë qenë të popullarizuara në vitet 1990. Fluturimet do të realizohen nga Brisbën, Melbërn apo Sidnej, me çmime prej 577 dollarëve amerikanë. Në paketën ditore përfshihen një mori

aktivitetesh.

Meqë kufijtë ndërkombëtarë ka mundësi që nuk do të rihapen deri më 2022 në Australi, Qantas i ka kërkuar qeverisë për siguri në udhëtimet e brendshme, meqë ka nisur procesi i vaksinimit. "Çfarë po kërkojmë ne është një garanci, që në një moment të caktuar të mos ketë më shumë mbyllje të kufijve", ka thënë drejtori ekzekutiv i Grupit Qantas Andrew Parker.

Kompanitë ajrore në gjithë Australinë janë duke shqyrtuar

strategji të ndryshme për të luftuar uljen e madhe të udhëtimeve si pasojë e pandemisë.

Kompania tajlandeze e fluturimeve "Thai Airways" ka njoftuar këtë javë se do ta zvogëlojë numrin e punëtorëve për 50 për qind. Pandemia ka dëmtuar rëndë këtë sektor, duke i përballur kompanitë ajrore me kërkesa për ndihmë nga qeveritë, falimentim apo zvogëlim të madh të numrit të punëtorëve.



## Një tërmet i fuqishëm goditi Greqinë



ATHINË, 3 MARS - Një tërmet prej 6.3 shkallë të Riterit të mërkurën ka goditur Greqinë Qendrore, tha Shërbimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara. Ende nuk ka raportime për lëndime në njerëz. Sipas mediave lokale, banorët në qytetin Larissa,

pas lëkundjeve të fuqishme kanë dalë në rrugë.

Ndërkaq, autoritetet greke thanë se tërmeti ishte 6.0 ballësh.

Epiqendra e tërmetit ishte 21 kilometra në jug të qytetit Ellassona, afër Larissas.

Dridhjet e tokës u ndjenë në

orën 12:15, sipas kohës lokale, duke bërë që shtetet e Ballkanit siç është Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Mali i Zi të kenë përjetuar dridhje të tokës. Greqia ka raportuar edhe për dridhje pasuese të tokës, pas këtij tërmeti të fuqishëm.

# KQZ-ja sot shpall rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) sot (e enjte) pritet ta shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të 14 shkurtit. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar se rezultati përfundimtar do t'i përfshijë rezultatet për të gjitha subjektet politike dhe kandidatët pjesëmarrës në zgjedhje

## “Epoka e re”

PRISHTINË, 3 MARS - Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se sot (e enjte) do të shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të 14 shkurtit. Në një konferencë për medie, ai ka treguar se Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është në përfundim të numërimit të fletëvotimeve nga jashtë Kosovës. “Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve jemi pothuajse në përfundim të numërimit të fletëvotimeve nga

jashtë Kosovës. Deri në orët e mbrëmjes numërimi i fletëvotimeve jashtë Kosovës do të përmbyllet. Pas përfundimit të numërimit, Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve i duhen disa orë kohë për t'i kryer procedurat e parapara për ta përmbyllur administrimin për rezultatin e zgjedhjeve”, ka thënë Elezi.

Ai ka treguar se rezultati përfundimtar do t'i përfshijë rezultatet për të gjitha subjektet politike dhe kandidatët pjesëmarrës në zgjedhje. “Ju njoftoj se rezultatet përfundimtare për subjektet

politike dhe kandidatët do të shpallen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ditën e enjte, më 4 mars. Rezultati përfundimtar do t'i përfshijë rezultatet për të gjitha subjektet politike dhe kandidatët pjesëmarrës në zgjedhje, sipas vendvotimeve, qendrave të votimit, komunave dhe rezultatet e votave me kusht e atyre me postë”, është shprehur Elezi.

Ndërsa numërimi i votave të diasporës ka përfunduar në orët e vona të së mërkurës.

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve ka bërë me dije se

deri në orën 16:00 janë numëruar mbi 47 mijë vota të diasporës. Sipas këtyre rezultateve,

Lëvizja Vetëvendosje ka marrë 36 696 vota të diasporës, Partia Demokratike e Kosovës 4 341, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 1 045, ndërsa Nisma Socialdemokrate 411 vota.

Pas procesit të vlerësimit, KQZ-ja kishte aprovuar 56 610 zarfe me fletëvotime nga diaspora, ndërsa 22 591 zarfe me fletëvotime kishte refuzuar. Sipas KQZ-së, arsyet e refuzimit kanë qenë të ndryshme dhe janë të kategorizuara në shtatë grupe kryesore. “9 199 zarfe janë dërguar nga persona që nuk janë të regjistruar si votues jashtë Kosovës, 6 665 zarfe janë dërguar nga persona që nuk kanë arritur të regjistrohen si votues jashtë Kosovës gjatë periudhës së aplikimit sepse

nuk kanë dëshmuar kriteret ligjore, 1 325 votues kanë dërguar fletëvotime nga dy herë, 2 451 zarfe të dërguara nga votues të paidentifikuar (votim grupor), 910 zarfe të dërguara nga votues të cilët kanë bashkangjitur dokumente jovalide për identifikim, 1 656 zarfe me fletëvotime jashtë rrethit të ngushtë familjar”, ka njoftuar KQZ-ja.

Sipas rezultateve preliminare për zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 47.85 për qind të votave, Partia Demokratike e Kosovës 17.41 për qind, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.08 për qind dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka fituar 7.43 për qind të votave. Ndërsa Nisma Socialdemokrate nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor.

## Freedom House: Shqipëria dhe Kosova, pjesërisht të lira

PRISHTINË, 3 MARS - Organizata Freedom House arriti në përfundim se në vitin 2020 aktorët autoritarë u bënë më të guximshëm, ndërsa demokracitë më të mëdha përballëshin me problemet e brendshme, duke sjellë si rezultat një rënie për të 15-in vit me radhë në lirinë botërore. Freedom House nxori raportin e saj vjetor të vitit 2021 për lirinë në botë, sipas të cilit, hendeuku mes rënieve

dhe përmirësimeve në nivelin e lirisë u thellua. Sipas raportit, Shqipëria ka rënë një pikë më poshtë, ndërsa Kosova dy pikë. Maqedonia e Veriut ishte një nga historitë e suksesit me tri pikë përmirësim nga një vit më parë. Sipas raportit Freedom House, Ballkani është mes rajoneve që ka pësuar rënie, por ka shënuar edhe disa përparime. Shqipëria dhe Kosova vazhdojnë të mbeten

pjesërisht të lira dhe kanë pësuar një rënie prej një pike dhe dy pikësh respektivisht. Shqipëria nga 67 pikë vitin e kaluar, ka 66 pikë këtë vit, me një pikë rënie në kategorinë e të drejtave të grumbullimit dhe organizimit, lidhur me dy ngjarje. Kosova pësoi një rënie prej dy pikësh gjithsej nga 56 në 54, që u atribuohen rënieve në kategoritë e procesit elektorale dhe pluralizmit politik.





LIDERI I LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI, KA SHPREHUR OPTIMIZËM PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

# Kurti: I kemi votat për qeverinë e re

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kandidat për kryeministër, Albin Kurti, është shprehur i bindur se i ka votat për formimin e qeverisë së re. Në Tiranë ai ka thënë se do t'i ketë më shumë se 61 deputetë për t'u bërë kryeministër i Kosovës dhe nuk ka nevojë për votat e partive të tjera. Kurti ka deklaruar se edhe Vjosa Osmani, aleatja e tij politike, do të bëhet presidente e vendit pa bërë asnjë kompromis

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 MARS - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), njëherësh kandidat për kryeministër, Albin Kurti, beson se shumë shpejt do të mund t'i formojë institucionet e reja. Ai është shprehur i bindur se i ka votat e nevojshme për t'u bërë kryeministër i vendit. Në një konferencë për media mbajtur

në Tiranë, Kurti ka thënë se do të ketë më shumë se 61 deputetë për qeverinë e re, duke përfshirë kështu një koalicion të mundshëm me partitë shqiptare dhe me Listën Serbe. "Do të jemi aty rrotull 60 deputetëve. Me siguri do ta kemi deputetin e komunitetit egjiptian Elbert Krasniqi, me siguri do ta kemi deputetin e komunitetit boshnjak Emilia Rexhepi, po ashtu do t'i kemi

edhe disa të tjerë. Na nevojiten 61 vota. Do ta kalojmë numrin 61. Nuk do të kemi nevojë për kompromise me eksponentët e regjimit të vjetër, sepse populli e do të renë. Populli e ka bërë prerjen. Nuk e kemi ndërmend t'ia shkelim vullnetin e t'ia devijojmë dëshirën", ka deklaruar Kurti. Lideri i LV-së beson se edhe Vjosa Osmani do të arrijë të bëhet presidente e vendit.

I pyetur nëse ka pasur takim në mes Kurtit, Osmanit dhe Murat Jasharit për postin e presidentit, ai e ka mohuar një gjë të tillë. "Çështjes së një kompromisi të aluduar me Osmanin dhe zotin Jashari nuk ka pasur një takim të tillë. Ne kemi bërë koalicionin parazgjedhor me Vjosa Osmanin, prandaj zgjedhjet ishin referendum. Populli nuk bën kompromise, por dëshiron ndryshime", ka thënë Kurti.

Nga Tirana, Kurti ka paralajmëruar se do të bëjë transformim të sistemit të drejtësisë. "Me qeverisjen tonë të re, me procesin e vetingut, me departamentet në gjykatat e reja, edhe do të zvogëlojmë atë

gjysmë milioni lëndë në Pallatin e Drejtësisë, por edhe do ta rregullojmë imazhin e Kosovës, duke sjell drejtësi për qytetarët e Kosovës, dhe gjykatat tona normale do t'i trajtojnë të gjitha pretendimet ndaj kujtdo qoftë", ka thënë Kurti.

Ai ka folur edhe për Gjykatën Speciale, duke thënë se ajo është një gjykatë e padrejtë dhe e imponuar. "Gjykata Speciale në Hagë është gjykatë që është imponuar prej jashtë. Është instaluar për shkak të votimit të gabueshëm, tejet të dëmshëm më 3 gusht të vitit 2015. Ne dëshirojmë të kemi gjykata normale në Kosovë, jo gjykata speciale jashtë Kosovës", ka thënë ai.

## Opozita nuk ka vota për Osmanin presidente

Pas rezultateve preliminare të zgjedhjeve të 14 shkurtit, partitë e tjera kanë pranuar rezultatin, duke e uruar fituesin. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja kanë pranuar se do të jenë në opozitë në këtë mandat, duke bërë me dije se nuk do të kenë vota për kandidaten e LV-së për presidente, Vjosa Osmani.

Vetë lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se kjo parti nuk do të qëndrojë në sallën e Kuvendit kur pritet të votohet Vjosa Osmani për presidente. "LDK-ja nuk do të rrijë në sallë. Osmani nuk është personi i duhur për president. Ne si LDK e kemi kandiduar për kryeministre në zgjedhjet e kaluara. Ajo ishte një femër e zonja dhe e zgjuar. Ajo ka dalë kundër LDK-së dhe kurdo që i bie pishman, ajo mund të kthehet. Vjosa e ka parë që është gabim që është larguar nga LDK-ja", ka thënë Mustafa.

Të njëjtën gjë e ka thënë ditë më parë edhe zëdhënësi i PDK-së, Avni Bytyçi. "Nuk besoj se Partia Demokratike e Kosovës që është votuar nga mijëra

qytetarë të jetë patericë e partive të tjera të cilat i kanë fituar këto zgjedhje dhe po tregohen të paafte për ta zgjidhur këtë çështje. Ne jemi parti opozitare. E tillë do të sillemi edhe në Kuvend. Partia Demokratike e Kosovës nuk ka votë për zonzjën Osmani presidente", ka deklaruar ai.

Ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ende nuk ka hequr dorë nga posti i presidentit. Zyrtarët e kësaj parti ende mendojnë se president i vendit duhet të jetë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Ne nuk kemi hequr dorë nga presidenca. Kemi të drejt, si çdo grup parlamentar, të konkurrojmë. Edhe ne si grup parlamentar konkurrojmë për kryetar të shtetit. Unë besoj se përderisa nuk merren vesh partitë politike do të ta kenë të vështirë ta zgjedhin qeverinë dhe presidentin", ka thënë për EO, anëtar i Kryesisë së AAK-së, Bali Muharremaj.

Neni 86 i Kushtetutës së Kosovës parasheh që zgjedhja e presidentit të bëhet jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentit aktual. Vjosa Osmani, që aktualisht është ushtruese e detyrës e

presidentit, mund ta mbajë këtë pozitë më së largu deri më 5 maj të këtij viti. Pika katër e nenit 86 thotë se zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Nëse në votimin e tretë asnjëri kandidat nuk merr shumicën e votave (61), Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja të cilat duhet të mbahen brenda 45-ditësh.

Osmani ka ardhur në këtë pozitë pas dorëheqjes së ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, më 5 nëntor 2020, kur i është konfirmuar aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nga Gjykata Speciale me seli në Hagë.

Sipas rezultateve preliminare për zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 47.85 për qind të votave, Partia Demokratike e Kosovës 17.41 për qind, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.08 për qind dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka fituar 7.43 për qind të votave. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është në përfundim të numërimit të votave me postë dhe pritet që shumë shpejt të shpallen rezultatet e zgjedhjeve të 14 shkurtit.

## Kurti: Me Tiranën do të kemi marrëdhënie më të mira

Lideri i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se do të jetë kryeministri që do të ketë marrëdhënie më të mira me Tiranën zyrtare në Kosovën e pasluftës. "Do të jem kryeministri që do të kem marrëdhënie më të mira me Tiranën zyrtare që ka pasur ndonjë kryeministër i Kosovës pas luftës. Do të zhvilloj kontakte dhe takime. Do të takoj drejtues shtetërorë. Kam një vizitë treditore për tre qytete për tre kandidatë", ka thënë Kurti.

Ai ka bërë me dije se sapo të krijohet Qeveria në Kosovë do të nisë bashkëpunimi me

Qeverinë e Shqipërisë. "Sapo të zgjidhet qeveria e re në Kosovë, menjëherë do ta fillojmë bashkëpunimin me Shqipërinë, bashkëpunimin me kryeministrin Edi Rama, meqë do ta formojmë qeverinë para zgjedhjeve këtu. Në këto shtatë vjet numri i marrëveshjeve Kosovë - Shqipëri është treshifror, ndërsa numri i zbatimeve është njëshifror. Është e domosdoshme të shkojmë nga marrëveshjet e shkruara në zbatim real të tyre. Bashkëpunimin me cilindo kryeministër në Shqipëri do ta kemi të shkëlqyer", ka thënë Kurti.

## Të infektuarit me Covid presin paratë nga komunat

PRISHTINË, 3 MARS - Remzi Krasniqi nga Prishtina është një nga qytetarët e parë që ka aplikuar për ndihmën financiare prej 50 eurove nga Komuna e Prishtinës, pasi ishte prekur nga sëmundja Covid-19. Kuvendi Komunal i Prishtinës, pak muaj pas paraqitjes së rasteve me koronavirus në Kosovë, kishte miratuar një vendim që qytetarëve të saj, nën moshën 65-vjeçe, të infektuar me koronavirus, t'u dalë në ndihmë me nga 50 euro, ndërkaq pensionistëve me 100 euro. Megjithatë, Krasniqi thotë se që nëntë muaj është në pritje të këtyre mjeteve. "Në muajin e pestë të vitit të kaluar e kam kryer Covidin dhe asgjë, nuk kanë dalë paratë. Nuk e di ku të ankojem më për ato 50 euro. Nuk janë para këto 50 euro. Do të duhej të ishin 300, 400 euro për t'i mbuluar ato shpenzime të familjes. Gjashtë anëtarë të familjes kemi qenë të mbyllur", ka thënë Krasniqi për "Radion Evropa e Lirë".

Edhe Mexhid Jetullahu, pensionist, është në pritje të 100 eurove pasi, po ashtu, ai ishte prekur nga Covid-19. "Edhe gruaja, edhe vetë kemi qenë me Covid-19. Kemi aplikuar dhe asnjëri nuk i kemi marrë paratë nga komuna. Pesë



analiza që i kam bërë kushtuan 37.30 euro. Edhe të shtunën e bëra një analizë, që ta shoh se a kam antitropa. Më kushtoi goxha shtrenjtë, e unë pensionist jam", ka thënë Jetullahu.

Rreth 23 000 qytetarët të Prishtinës kanë aplikuar për këtë ndihmë financiare, në mesin e të cilëve 2 819

pensionistë. Deri më tash, Komuna e Prishtinës në total ka paguar 467 100 euro dhe 106 450 euro janë në pritje për t'u realizuar për 1 824 qytetarë që figurojnë të verifikuar dhe të siguruar, deklaroi për "Radion Evropa e Lirë", nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi.

Ai pranoi se ka vonesa në

alokimin e mjeteve nga komuna te qytetarët dhe njëra nga arsyet është edhe koha që kërkohet për verifikimin e qytetarëve që i takojnë Komunës së Prishtinës. "Kemi pasur deri tash rreth 800 raste ku qytetarët nga komunat e tjera kanë aplikuar për këtë ndihmë, pra duhet të kemi shumë kujdes se si po i

shpërndajmë këto para publike. Do të thotë, duhet një durim i qytetarëve, dhe e dyta jemi duke pritur bartjen e mjeteve të vitit të kaluar. Kjo do të bëhet në mbledhjen e kuvendit. Unë besoj që në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal (në muajin mars), do të jetë një nga pikat e rendit të ditës bartja e mjeteve, ku do të aprovohen edhe 4 milionë të tjera, të cilat kanë mbetur pa u shfrytëzuar nga viti i kaluar", ka thënë Nushi.

Deri më 28 shkurt, 27 302 qytetarë të Prishtinës janë prekur nga koronavirusi. Ndihmë financiare për të prekurit me Covid-19, në nëntor të vitit të kaluar ka premtuar edhe Komuna e Mitrovicës së Jugut, me nga 50 euro për secilin qytetar. Qytetarët janë ende në pritje të parave. Në Mitrovicën e Jugut, nga muaji nëntor deri në dhjetor të vitit të kaluar, mbi 1 000 qytetarë kanë aplikuar për këtë ndihmë. Qeveria në detyrë e Kosovës, në programin e saj për rimëkëmbje ekonomike për vitin 2021, ka planifikuar edhe ndihmë apo mbështetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Për komunat është ndarë shuma prej 7 900 000 eurosh.

# Dy ekipe italiane në kuadër të KFOR-it dezinfektuan shkollat e Prishtinës dhe të Mitrovicës

PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Dy ekipe të specializuara italiane nga Komanda Rajonale e KFOR-it Perëndim, kanë kryer operacione të dezinfektimit në shkollat e Prishtinës dhe Mitrovicës. "Aktivitetet e pastrimit dhe dezinfektimit, të koordinuara me menaxherët e shkollës dhe autoritetet lokale shëndetësore, u kryen gjatë fundjavës në mënyrë që të sigurohen kushtet për shëndetin dhe sigurinë e studentëve

mësimdhënësve që ndjekin shkollat çdo ditë. Të dy ekipet përbëhen nga gjashtë operatorë të trajnuar për të vepruar në mjedise të kontaminuara. Ata kanë përvojë të lartë në operacionet e mëparshme të kryera në Itali dhe jashtë saj në dezinfektimin e automjeteve, mjediseve dhe objekteve", është bërë me dije në njoftimin e KFOR-it. Në këtë njoftim është theksuar se misioni i KFOR-it, udhëhequr nga NATO në Kosovë, që nga


fillimi i pandemisë Covid-19 ka ofruar ndihmë për të gjitha komunitetet në Kosovë përmes dhurimit të pajisjeve mbrojtëse personale dhe dezinfektimit të strukturave të shumta publike. "Ky ofrim i ndihmës shëndetësore për institucionet në Kosovë, për përballimin e epidemiologjisë Covid-19, bëhet në mbështetje të mandatit të KFOR-it të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB të vitit 1999", është thënë në këtë njoftim.



# Promovohet libri i Bajram Kosumit "Letërsia nga burgu"

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 MARS - Në Shkup është bërë promovimi i librit të rektorit të Universitetit "Kadri Zeka", prof. dr. Bajram Kosumi, me titull "Letërsia nga burgu". Për librin "Letërsia nga burgu" kanë folur recensenti dr. Emin Azemi dhe kritiku prof. ass. dr. Bashkim Musliu. Në promovimin e këtij libri kanë marrë pjesë zëvendëskryeministri i parë shqiptar në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, dr. Skender Asani, ambasadori i Republikës së Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, drejtori i Agjencisë për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Gjyhës Shqipe Ylber Sela, kryesuesi i Këshillit Drejtues në UKZ, Ibrahim Kosumi, dekani i Fakultetit të Edukimit, prof. asoc. dr. Merxhan Avdyli, poetë, profesorë, gazetarë dhe dashamirë të librit.



Libri është kapitull më vete në letërsinë shqipe (botim i përpunuar), botim i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në

Shkup. Në libër trajtohet letërsia shqipe e krijuar në burg gjatë periudhës 1945-1999. Libri ka 350 faqe, ndahet në

tetë kapituj, të cilëve u paraprin një parathënie dhe përmbyllet me përfundimet. Në libër trajtohen veprat letrare të shumë poetëve e të

shkrimtarëve që krijuan në burgje, citohen shumë autorë kanonikë në fushë të letërsisë dhe bëhen krahasime me letërsi të ngjashme evropiane e më gjerë.

Poetë dhe shkrimtarë shqiptarë që shkruan në burgje, tekstet e të cilëve, më shumë ose më pak, janë analizuar në këtë libër: Adem Demaçi, Atë Zef Pllumi, Arshi Pipa, Visar Zhiti, Kasëm Trebeshina, Merxhan Avdyli, Ismail Sylja, Trifon Xhagjika, Jorgo Bllaci, Genc Leka, Vilson Blloshmi, Havzi Nela, Mehmet Myftiu, Hydajet Hyseni, Pjetër Arbnori, Murteza Xajë Nura, Pano Taçi, Zyhdi Morava, Rexhep Elmazi, Maks Velo, Drita Çomo, Alush Canaj, Frederik Reshpja, Zeqir Gërvalla, Vezir Ukaj, Sylë Mujaj, Besim Zymeri, Rasim Selmani, Berat Luzha, Fazli Greiçevci, Daut Gumeni, Fatos Lubonja, Gani Sylaj, Muhamet Rogova, Emin Kabashi, Kurt Kola, Kolë M. Berisha, Martin Çuni, Enver Topalli, Rrahim Sadiku, Fehmi Berisha, Jahja Luka, Zhaneta Ogranja etj.

# 37 bibliotekave komunale MKRS-ja ua shpërndan nga 210 tituj të rinj

PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Bibliotekat e komunave të Kosovës që nga sot fondin e tyre librar do ta kenë më të pasur me 210 tituj të rinj të librave fal përkrahjes së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Me politikën e saj për librin, MKRS-ja mbështet financimin e botimit dhe të blerjes së tij. Më pas, kontingjentin e blerë të librit e shpërndan çdo vit për bibliotekat komunale të Kosovës, siç u organizua edhe ceremonia e sivjetme në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës (BKK). Në këtë ceremoni morën

pjesë ministrja në detyrë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, kryesuesi i Këshillit Drejtues i Bibliotekës Kombëtare, Osman Gashi, zyrtarë të MKRS-së dhe përfaqësues të bibliotekave komunale të Kosovës. Me këtë rast, ministrja Dumoshi vlerësoi se libri, si miku më i mirë, sot na ka bërë bashkë. Ajo u shpreh se ministria e përkrah botimin e librit, i blen librat e ri të botuar nga shtëpitë botuese dhe ua shpërndan bibliotekave tituj e ri që ato ta pasurojnë fondin e tyre bibliotekar. "MKRS-ja me

politikën e saj për disa vjet ka fuqizuar dhe ka ndjekur një rrugë të shpërndarjes së librave dhe uroj që edhe kryetarët e komunave të jenë më koshentë që përmes subvencioneve ose pjesëve programore ta sigurojnë një buxhet për këto biblioteka", ka deklaruar ministrja Dumoshi, e cila ka thënë se buxheti dhe përkrahja për librin rritet për çdo vit. Ministrja sqaroi se ky fond i librave me 27 tituj shpërndahet në 37 komuna të Kosovës si dhe në pjesën e Luginës së Preshevës. Në emër të përfaqësuesve të



bibliotekave komunale, foli drejtori i Bibliotekës së Komunës së Prishtinës, Munish Hyseni, i cili tha se

ata bëjnë pyetësor çdo vit, për të marrë informacion se çfarë u intereson anëtarëve të bibliotekës të lexojnë.

## Rriten rastet me Covid në Kosovë, 568 raste të reja për 24 orë

Kosova ka regjistruar të mërkurën numrin më të lartë të rasteve pozitive me Covid-19 për këtë vit. Sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), 568 raste pozitive u konfirmuan pas testimit të 2 532 mostrave. Numri më i madh i tyre është në Prishtinë, 233

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MARS - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 532 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 568 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar katër raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren dy raste (56, 60 vjeç), Fushë-Kosovë një

rast (84 vjeç), Suharekë një rast (85 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 70 753 raste nga 315 664 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 620 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 295 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 60 628 raste, kurse numri i rasteve aktive është 8 505.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 233 raste, Pejë 47 raste, Gjakovë 29 raste, Gjiilan 28 raste, Lipjan 26 raste, Podujevë 23 raste, Kamenicë 22 raste, Vushtrri 22 raste, Ferizaj 20 raste, Mitrovicë 20 raste, Fushë-Kosovë 16 raste, Viti 12 raste, Obiliq 11 raste, Rahovec 11

raste, Suharekë 10 raste, Skenderaj 9 raste, Deçan 7 raste, Prizren 7 raste, Kaçanik 5 raste, Shtime 3 raste, Dragash 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog, Klokot, Malishevë, Novobërdë dhe Shtërpçë. "Mjekët të stërngarkuar në spitale po luftojnë kundër këtij

virusi tinëzar e shkatërrimtar me tërë fuqinë e tyre profesionale dhe njerëzore. IKShPK-ja përsërit thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. Masat parandaluese janë të njëjta, me theks të veçantë se

personat pozitivë duhet të qëndrojnë në shtëpi për ta parandaluar përhapjen në familje dhe në komunitet. Me zvogëlimin e kontakteve do ta bëjmë të mundur ndërprerjen e përhapjes së infeksionit", është bërë me dije në apelin e IKShPK-së.

## Më 5 mars mbahet manifestimi 'Epopeja e UÇK-së'



Prishtinë, 3 mars (ER) - Në kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Prishtinë, më 5 mars, në orën 12:00, do të mbahet manifestimi qendror Parada e FSK-së, për nder të 23-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në kujtim të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit, si dhe të gjithë të rënëve për liri.

Në manifestim do të marrin pjesë ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë Avdullah Hoti, ministri i Mbrojtjes Anton Quni, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ministra dhe

zëvendësministra në detyrë, stafi diplomatik, përfaqësues të KFOR-it, Ekspit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NALT), atashe ushtarakë, zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, ushtarë dhe oficerë të FSK-së. Fjalë rasti në këtë manifestim do të mbajë ushtruesja e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, kryeministri Avdullah Hoti, përfaqësuesi i familjes Jashari dhe i veteranëve të luftës së UÇK-së.

Manifestimi për "Epopenë e UÇK-së" mbahet nën organizimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës. Manifestimi "Epopeja e UÇK-së" këtë herë do të jetë manifestim i tipit të mbyllur për shkak të pandemisë Covid-19.

## 61 qese me substanca narkotike bëhet përpjekje të futen në Qendrën Korrektuese në Dubravë

PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Të mërkurën rreth orës 11:00 në Qendrën Korrektuese në Dubravë, gjatë një bastisje të organizuar nga Departamenti i Sigurimit në Zonën Industriale (sektori i Agrikulturës), në pjesën perëndimore afër murit, përafërsisht dhjetë metra në brendësi të zonës është gjetur një qese e mbushur me substancë të dyshuar

narkotike.

Pas hapjes së qeses së dyshuar, brenda saj ishin vendosur 61 qese në sasi të vogla, të mbështjella veç e veç, të cilat dyshohet se janë substancë narkotike. "Qesja me sasi të dyshuar narkotike dyshohet se është hedhur mbi muri nga pjesa e jashtme. Vlen të theksohet se kontrabanda e gjetur është parandaluar të

futet brenda zonës së banuar. Shërbimi Korrektues i Kosovës mbetet i përkushtuar për luftimin kontrabandës brenda institucioneve korrektuese dhe asnjëherë nuk do të qëndrojë duarkryq përballë këtyre dukurive negative të cilat rrezikojnë rendin dhe sigurinë e saj", është thënë në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.



## Shkolla "Lidhja e Prizrenit" në Deçan bëhet me kabinet të informatikës



Deçan, 3 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, bashkë me nënkryetarin Sami Cacaj, zyrtarë të DKA-së, janë pritur nga drejtori i ShFMU "Lidhja e Prizrenit" në Deçan, Qazim Maloku, zëvendësdrejtori Afrim Balaj dhe personeli i shkollës, ku bashkë kanë përruar kabinetin e

informatikës në këtë shkollë. Me mjetet e ndara nga buxheti i komunës janë dhuruar dhjetë loptopë si dhe pesë loptopë donacion nga Ministria e Arsimit. Ramosaj e ka falënderuar ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj për mbështetjen e vazhdueshme për shkollat e Komunës së

Deçanit. "Edhe në ditët në vijim do të vazhdojmë digjitalizimin e shkollave në Komunën e Deçanit", ka thënë Ramosaj, duke shtuar se teoria dhe praktika janë të domosdoshme në këtë kohë. "Jemi të përkushtuar që të krijojmë kushte të mira për nxënës dhe për mësuesin", është shprehur Ramosaj.

## Gjilani në javën e fundit shënon rritje të madhe të infeksionit me Covid-19

GJILAN, 3 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në konferencën për media mbajtur të mërkurën, është shprehur se në këtë komunë në javën e fundit ka rritje të madhe të infeksionit me Covid-19. "Sot i kemi 247 raste aktive dhe është rritje drastike e infeksionit me Covid-19 në javën e fundit. Kemi trefishim të rasteve të vizitave në shtëpi të pacientët e prekur nga virusi. Pra, janë deri në 50 vizita shtëpiake që ekipet e Qendrës së Mjekësisë Familjare i realizojnë. Ndërkohë, të hospitalizuar të konfirmuar me Covid-19 janë 47 pacientë, të cilët po trajtohen në Spitalin e Përgjithshëm, 6 prej të cilëve në gjendje më të rëndë",


ka thënë Haziri pas takimit të Komitetit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Ai ka pohuar se burim i infeksionit në Gjilan janë vizitat për ngushëllime dhe ahengjet e vogla familjare, por jo edhe institucionet shkollore e ato publike. "Po punojmë për një Gjilan pa virus, por deri në ardhjen e vaksinave duhet të kemi kujdes sipas rekomandimeve të IKShPK-së. Rritja e infeksionit është tregues i qartë që duhet t'u kushtojmë rëndësi masave mbrojtëse, përdorimit të maskës dhe distancës, në mënyrë që ta preventojmë përhapjen", ka thënë Haziri.



## Komuna e Podujevës kundërshton ndërtimin e hidrocentralit në lumin Kaçandolli

PODUJEVË, 3 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka marrë pjesë në debatin publik për raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për ndërtimin e hidrocentralit në lumin Kaçandoll në pjesën e Komunës së Vushtrrisë dhe Podujevës. Në këtë debat me përfaqësues të kompanisë "Hidrocom" sh.p.k., përfaqësues të komunitetit, grupeve të interesit, anëtarë të ekzekutivit të Komunës së Podujevës, kryetari Shpejtim Bulliqi ka theksuar se kompania "Hidrocom" sh.p.k., duke shpërfillur plotësisht vendimet e komunës, e cila dy herë ka refuzuar ta pajisë këtë kompani me leje mjedisore, ka marrë pëlqim nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit



(MEA) për realizimin e projektit për ndërtimin e hidrocentralit, në rrjedhën e lumit Kaçandoll, në territorin e Komunës së Podujevës. "Kompania në mënyrë të njëanshme, duke bashkëpunuar vetëm me Ministrinë e Ekonomisë dhe

Ambientit (MEA) dhe pa lejen e Komunës së Podujevës, për të cilën është refuzuar dy herë, ka filluar procedurat e realizimit të projektit. Prandaj edhe na ka detyruar neve si komunë të ushtrojmë padi për ta kundërshtuar formën arbitrarë

të dhënies së këtij pëlqimi mjedisor nga MEA", ka deklaruar Bulliqi.

Ai ka thënë se edhe forma e organizmit të këtij dëgjimi publik, krejt formale dhe pa bashkëpunim me banorët e këtyre fshatrave, është tregues i qartë i përpjekjes për fillim të heshtur të realizimit të këtij projekti i cili dëmton ambientin-pasurinë natyrore të këtyre fshatrave. "Ne do të vazhdojmë ta kundërshtojmë këtë projekt, për të cilin kemi edhe përkrahjen e banorëve të kësaj pjese. Orientimi ynë është që për këto zona të ofrojmë investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe nxisin investime në zhvillimin dhe promovimin e turizmit dhe assesi nuk lejojmë projekte që

shkaktojnë degradim mjedisor", ka thënë Bulliqi.

Edhe përfaqësuesi i fshatit Popovë, Muhamet Murati, në emër të banorëve të fshatrave përgjatë lumit Kaçandoll, ka thënë se në asnjë rast nuk është konsultuar komuniteti dhe ka shprehur kundërshtimin e tyre për realizimin e këtij projekti, i cili bie ndesh edhe me Strategjinë Lokale për Zhvillim të Turizmit, strategji për të cilën kanë kontribuar këta banorë. Ndërsa përfaqësuesi i kompanisë "Hidrocom" sh.p.k., Adnan Elshani, ka pohuar se kompania në fjalë, sipas legjislacionit në fuqi, ka organizuar këtë debat. Ai ka theksuar se pëlqimi mjedisor është marrë sipas kriterëve të ministrisë.

## Drejtorja e Inspektoratit në Prizren rrënon dy objekte

PRIZREN, 3 MARS (ER) - Drejtorja e Inspektoratit në Prizren ka rrënuar dy objekte për shkak se objektet në fjalë ishin ndërtuar në pronën e komunës.

Drejtorja e Inspektoratit ka njoftuar se vendimi për rrënimin e objekteve në fjalë është marrë pasi që investitori ka vazhduar punimet drejt përfundimit të

objekteve, përkundër urdhrit të DI-së për ndalimin e punimeve. Ndërkaq ankesat e parashtruara nga investitori në Komisionin e Komunës së Prizrenit dhe, po ashtu, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, janë kthyer me përgjigje negative. Po ashtu, investitorit i është dhënë afati 15-ditor për rrënimin e

objekteve në mënyrë vullnetare, por i njëjti nuk është përmbytur këtij afati të përcaktuar në bazë të ligjit.

Drejtorja e Inspektoratit ka apeluar te të gjithë qytetarët që të mos fillojnë ndërtimin e objekteve pa leje dhe se në të kundërtën do të merren masa sipas ligjeve në fuqi.





# Auditori i Përgjithshëm viziton Turqinë, merr mbështetje nga presidenti i EUROSAT-t

Prishtinë, 3 mars - Me ftesë të presidentit të Gjykatës Turke të Llogarive dhe EUROSAT-t, Seyit Ahmet Baş, Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Besnik Osmani, të mërkurën ka zhvilluar një vizitë pune në selinë e Gjykatës Turke të Llogarive në Ankara. Ky takim kishte për qëllim koordinimin e aktiviteteve në mes dy institucioneve për pjesëmarrje aktive të ZKA-së në forumet e EUROSAT-t, si dhe përgatitjet për pjesëmarrjen dhe prezantimin e ZKA-së si anëtarja më e re në Kongresin e

XI të EUROSAT-t, i cili do të mbahet në muajin e ardhshëm. Me këtë rast, presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive, Seyit Ahmet Baş, ka përgëzuar Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, Besnik Osmani, për angazhimin e vazhdueshëm dhe rezultatet e arritura në ndërkombëtarizimin e ZKA-së, duke thënë se anëtarësimi në EUROSAT tregon se sa e përgatitur dhe profesionale është Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës. Ndërsa Auditori i Përgjithshëm

i Republikës së Kosovës, Besnik Osmani, ka vlerësuar lart punën e Seyit Ahmet Baş gjatë kryesimit të EUROSAT-t dhe mbështetjen e vazhdueshme dhënë ZKA-së për integrimin në organizatat ndërkombëtare. Krerët e të dyja institucioneve kanë shprehur gatishmërinë për ta thelluar bashkëpunimin bilateral përmes planit konkret të aktiviteteve për përmbushjen e marrëveshjes së bashkëpunimit të arritur në vitin 2018. Në takim vëmendje e veçantë u është kushtuar aktiviteteve dhe

vendimeve të Institucioneve Supreme të Auditimit të Turqisë dhe Kosovës, si reagim ndaj pandemisë Covid-19, me ç'rast palët shpalosën detaje lidhur me auditimet për Covid-19. Më tutje, zyrtarë të lartë dhe auditorë kanë prezantuar përvojat e Gjykatës Turke të Llogarive në kontrollin dhe sigurimin e cilësisë në pajtim me standardet; përvojat në auditimin e TI-së; përvojat në sistemin e menaxhimit të auditimit si dhe përvojat në sistemin për analizimin e të dhënave.

Ndërsa delegacioni i Kosovës ka shpalosur arritjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, përfshirë këtu përmbushjen e misionit kushtetues e ligjor, forcimin e kapacitetit institucional dhe zhvillimin e marrëdhënieve të mira me palët e jashtme. Po ashtu, është biseduar edhe për zhvillimet e fundit në përditësimin e metodologjisë së auditimit si dhe vënien në përdorim të sistemit elektronik të auditimit, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe transparencës në procesin e auditimit.



## Pritet rritja e çmimeve të derivateve të naftës në Kosovë



PRISHTINE, 3 MARS - Ditët e fundit në Kosovë ka pasur rritje të çmimit të derivateve. Rritje të çmimeve është paralajmëruar se do të ketë edhe në ditët në vijim. Aktualisht çmimi i naftës në Kosovë është 0.98 centë, ndërsa i benzinës 1.00 euro, ndërsa ky çmim pritet të rritet për 05 centë. Lirim të çmimit të derivateve deri në 0.80 centë kishte pasur një vit më herët kur në Kosovë ishin shënuar rastet e para me Covid-19. Teksa ka pranuar se ka rritje të

çmimeve të derivateve ditët e fundit, kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka thënë se në rritjen e çmimeve ndikojnë berëza dhe OPEK-u. Pavarësisht prej kësaj, ai ka thënë se në Kosovë çmimet e derivateve të naftës janë më të lirë në rajon. "Në tregjet ndërkombëtare ka rritje të çmimit e kjo do të reflektojë në ditët në vijim edhe te ne në Kosovë. Këto ditë çmimi është duke u rritur. Mund të themi lirish një rritje shumë e lehtë

me nga 01 cent në ditë, por në çmimet me pakicë nuk janë duke u lëvizur. Këto çmime janë që një kohë të gjatë. Përafërsisht pritet të ketë rritje deri në 05 centë. Kjo ndikon në mënyrë automatike, kështu çmimi sot është mesatar diku 0.98 centë. Pra, do të thotë se do të kemi mbi 1.00 euro çmimin në tregun tonë", ka thënë Berjani. Në rritjen e çmimit të derivateve, Berjani ka thënë se është duke ndikuar prodhimi i ulët që po bëhet.

## Ekonomia kanadeze tkurret për 5.4 për qind

OTAVË, 3 MARS - Ekonomia kanadeze është tkurur për 5.4 për qind për vitin 2020 për shkak të pandemisë Covid-19. Siç njofton Zyra Kanadeze e Statistikave, të dhënat e Prodhimit të Brendshëm

Bruto u rritën 2.3 për qind në tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Ekonomia e vendit u tkurr 1.9 për qind në tremujorin e parë të vitit të kaluar për shkak Covid-19 dhe masave të marra kundër

pandemisë dhe rritje prej 8.9-përqindësh u arrit në tremujorin e tretë 2020 me relaksim të masave pas tkurrjes prej 11.4-përqindësh në tremujorin e dytë 2020. PBB-ja e vendit ra me 5.4 për

qind në vitin 2020. Kjo rënie ishte më e larta vjetore që nga viti 1961, kur për herë të parë u regjistruan të dhënat tremujore. Ndërkaq, ekonomia kanadeze në vitin 2019 ishte rritur 1.9 për qind.



# Diplomacia shqiptare, midis europeanizmit e sovranizmit, larg modelit 'sui generis Evropian'



**Prof. Lisen BASHKURTI**

Edhe në takimin e para pak ditësh në Bruksel të Këshillit të Asocimit midis KE-së dhe Shqipërisë u vërejtën diferencat diplomatike në qasjen midis KE-së dhe shteteve të veçanta të organizatës ndaj Shqipërisë. Natyrisht të shumta janë problemet me të cilat po haset Shqipëria në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. Pa u futur në kompleksitetin e tyre, për vetë fushën e njohjes, të dijeve, përvojës dhe praktikës time do të fokusohem vetëm në sfidën kryesore të diplomacisë që, ndonëse nuk bie shumë në sy publik, sërish është po aq serioze sa edhe fushat e tjera si ato politike, ekonomike, ligjore dhe administrative.

Sfida kryesore e diplomacisë në procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian buron në mënyrë të dyanshme: nga vetë procesi i transformimit dhe karakteristikave të diplomacisë së BE-së pas Traktatit të Lisbonës, si dhe nga trashëgimia jo e transformuar e diplomacisë shqiptare ndaj BE-së. Në këtë dyanshmëri, ajo që nevojitet të ndryshojë, të përshtatet dhe të zhvillohet, para së gjithash, është diplomacia shqiptare, e cila po tenton që të bëhet pjesë e diplomacisë së BE-së pa humbur karakteristikat individuale si shtet i pavarur dhe sovran në familjen e kombeve të botës.

## 1. Diplomacia e BE-së pas Traktatit të Lisbonës

Përpara Traktatit të Lisbonës diplomacia e BE-së vuante nga inkoherenca serioze horizontale dhe vertikale që buronin nga ndarja e kompetencave midis BE-së dhe shteteve anëtare, që udhëhiqeshin nga një formë supernacionale (federaliste) e ndërqeveritare (sovraniste) e përfaqësimit diplomatik, me shumë qëndrime të aktorëve, organizuar në një strukturë të shpërndarë autoriteti dhe

legjitimiteti dhe në kushtet e mungesës së qartësisë ligjore.

Traktati i Lisbonës dhe Veprimi i Shërbimit të Jashtëm Evropian (EEAS) që u krijua lehtësoi disa probleme. Por la sërish pas disa të tjera. Pengesa kryesore në përfaqësimin koherent dhe të unifikuar diplomatik nuk është mënjeluar tërësisht me Traktatin e Lisbonës. Natyra sui generis e Bashkimit Evropian, e ndërtuar midis një shteti federal dhe një organizate ndërkombëtare rezultoi në rrjetin e organizimit të diplomacisë së saj, Veprimin të Shërbimit të Jashtëm të Evropian (EEAS), që vazhdon të bashkekzistojë me shërbimin diplomatik të 27 shteteve anëtare sovraane.

Ajo që ka ndryshuar me Traktatin e Lisbonës dhe krijimin e EEAS është mekanizmi koordinues me një rrjet më pak kompleks, më qartësisht të ndarë dhe më të dukshëm në përfaqësimin ndërkombëtar, gjë që padyshim e ndihmon BE-në të ndërtojë imazhin e vet më pranë aktorit shtet të tipit Vestfalian. Gjithashtu, natyra jo shtetërore e BE-së vazhdon të paraqesë probleme serioze të përfaqësimit koherent në organizatat ndërkombëtare, madje edhe kur ekziston marrëveshje politike brenda BE-së.

Në rrafshin brenda Brukselit, EEAS koordinon gjithë strukturat burokratike, duke sjell një përmirësim të dukshëm koherent horizontal të diplomacisë së BE-së. Në rrafshin ndërkombëtar, ajo që ka ndryshuar me Traktatin e Lisbonës dhe EEAS është thjeshtësimi i rrjetit, me zhdukjen e Presidencës së misionit diplomatik në fushat e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët (CFSP). Aktualisht, pas Traktatit të Lisbonës, delegacionet e BE-së përfaqësojnë Bashkimin Evropian si union në tërësi më gjithë politikave të tij, kështu që ndarjet midis politikave supernacionale (federaliste) dhe ndërqeveritare (sovraniste) janë tani të përfshira brenda EEAS. Impakti kryesor i këtij inovacioni institucional mbetet për t'u provuar në praktikë, për arsye se do të varet jo vetëm nga ndërtimi formal, por edhe nga mënyra sesi aktorët e përfshirë do të adoptojnë praktikën e reja të koordinimit që do të lejojë BE-në të ketë një përfaqësim të

unifikuar si një aktor i vetëm ndërkombëtar. Kjo, gjithashtu do të varet nga dinamikat e socializimit midis stafit të ardhur nga Komisioni, Sekretariati Këshillit dhe, jo më me pak rëndësi, të shërbimeve diplomatike të shteteve anëtare. Ndryshimet institucionale inovative dëshmojnë se ndryshimi strategjik në diplomacinë e BE do të dojë kohën e vet.

Ndryshimet e bëra në diplomacinë e BE-së kanë nevojë për më shumë efikasitet dhe koherencë me qëllim që të mbrojnë më mirë interesat e BE-së në marrëdhënie ndërkombëtare. Kjo sjell një thyerje të nocionit të mëparshëm strukturor të diplomacisë dhe kthimit tek

mënyrat Vestfaliane të pjesëmarrjes në marrëdhënie ndërkombëtare. Kjo rrëshqitje strategjike në drejtim të paradigmes së mbrojtjes së interesave në një logjikë konkurruese me aktorë të tjerë nuk është pa probleme. Nëse shteti Vestfalian si një formë organizacionale ishte dhe mbetet problem për bashkekzistencën paqësore midis popujve, rikrijimi i këtij lloj shteti shtetit në nivel Evropian, pra federalizmi, nuk mund të jetë një zgjidhje pa probleme. Gjithsesi rrëshqitja strategjike e diplomacisë së BE-së përmes inovacionit institucional do të thotë që BE-ja është duke adoptuar me sukses kulturën diplomatike dhe praktikën

ekzistuese në sistemin ndërkombëtar përgjithësisht dhe në këtë mënyrë është duke avancuar në procesin e ardhjes drejt termave në realitetet e reja të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në fakt, inovacionet institucionale janë indikatorë që BE-ja është maturuar si një aktor ndërkombëtar.

## 2. Diplomacia e BE-së dhe shteteve anëtare në politikën e zgjerimit

Sikundër e parashtruar më lart, diplomacia e BE-së pas Traktatit të Lisbonës ka rrëshqitur drejt një strategjie më eficiente dhe më koherente në marrëdhëniet



ndërkombëtare. Si e tillë, kjo efikasitet dhe koherencë po shfaqet edhe në politikën e fqinjësisë dhe të zgjerimit.

Por, pavarësisht këtij avancimi si aktor ndërkombëtar koheziv dhe i unifikuar sidomos në politikën ku arrihen marrëveshje brenda Unionit, sërish nga vetë natyra formësore e BE-së midis strukturës supranacionale (federalizmit) dhe strukturës ndërqeveritare (sovrانيت), diferencat vijojnë të mbeten edhe në politikën fqinjësore dhe ato të zgjerimit.

Veprimi i Shërbimit të Jashtëm Evropian (EEAS) si një strukturë përfaqësuese e legjitime e unionit në qasjet ndërkombëtare përfaqësohet nga delegacionet e BE-së jashtë organizatës. Këto delegacione përfaqësojnë imazhin e entitetit të Unionit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndërkohë, 27 shtetet anëtare kanë përfaqësitë e tyre diplomatike paralelisht me delegacionin e Unionit. Qëllimet, misionet, objektivat, prioritetet e këtyre dy entiteteve diplomatike nga hapësira gjeopolitike e Kontinentit,

ndonëse nuk janë përjashtimisht të kundërta, nuk janë gjithsesi as të njëjta, madje ndonjëherë as të përafërta. Diplomatisht Evropa vijon të shpaloset nëpër botë me diplomacinë Vestfaliane dhe me atë Evropiane, pra me një strukturë ku bashkekzistojnë federalizmi dhe sovranizmi.

Në rastin e politikave të integritit diplomacia e BE-së lëviz nëpërmjet këtyre dy pistave diplomatike, federalizmit dhe sovranizmit ose midis diplomacisë Evropiane dhe Vestfaliane ose midis kulturës dhe praktikës diplomatike tradicionale të aktorit-shtet dhe kulturës dhe praktikës innovative institucionale post Lisbonë të aktorit-kontinent. Këto dy pista diplomatike shtrihen nga Brukseli në kryeqytetet Evropiane drejt vendeve dhe qendrave të tjera ndërkombëtare, përfshirë edhe vendet kandidatë për në BE.

Në politikën e zgjerimit këto dy pista diplomatike, federaliste dhe sovraniste ose Evropiane dhe Vestfaliane, ose innovative dhe tradicionale të

lartpërmendura janë shumë të larmishme dhe dinamike. Në varësi të vlerave dhe interesave të përfaqësimit këto dy pista diplomatike herë afrohen, herë largohen, herë ecin paralel dhe herë përputhen. Politikën e zgjerimit të BE-së janë kështu në varësi dhe në ndikim të dyfishtë. Aktorët kandidatë për anëtarësim në Union vëzhgohen, analizohen dhe gjykohen nga perspektiva të ndryshme diplomatike Evropiane dhe Vestfaliane, pra nga delegacionet e EEAS dhe përfaqësitë e shteteve anëtare, në të njëjtën kohë. Në këtë pistë të dyfishtë lypet të luajë diplomacia e vendeve kandidatë, për të përçuar qartësisht imazhin e saj në Unionin sui generis.

### 3. Adoptimi i diplomacisë së vendeve kandidatë

Evropa e dyzuar diplomatikisht, e tillë është në konstitutionin e saj. Diplomacia e saj edhe zgjerimit i qaset njëherazi mënyrës evropiane dhe modelit Vestfalian. Sistemi i vlerave,

gama e interesave, qëllimet, misionet, objektivat, prioritetet janë dinamike dhe të larmishme. Vendet kandidatë 'lundrojnë' në këtë mjedis të rrëshqitshëm, herë-herë duke ecur në drejtimin e duhur konsensual midis dy pistave të diplomacisë në Evropë, herë duke anuar nga Vestfalizmi, herë nga evropianizmi pa arritur të gjejnë pikëtakimet midis tyre.

Këtu qëndron roli kryesor i diplomacisë së vendeve kandidatë, e cila lypet gjatë tërë kohës të 'lundrojë' midis Vestfalizmit dhe Evropianizmit, duke synuar gjithnjë të arrijë pikëtakimet midis tyre ose të gurmtojë e të qëmtojë me kujdes filigrane konsensusin politik midis tyre në qasjen ndaj vendit kandidat të dhënë. Europianizimi i diplomacisë në vendet kandidatë, përfshirë Shqipërinë kryesisht që po sfidohet prej vitesh nga diplomacia e BE-së, kërkon që të ndërtohet diplomacia mikse e ngritur midis pikëtakimeve Evropiane dhe Vestfaliane.

Mos përputhjet midis Vestfalianëve dhe Evropianëve ndaj një vendi kandidat, siç është rasti i Shqipërisë, mund të rezultojnë problematik. Nëse diplomacia e vendit kandidat përplasat midis mospërputhjeve Evropianizmit dhe Vestfalizmit, në vend që të ngrihet mbi pikëtakimet e tyre, procesi i zgjerimit mund të shtyhet në 'kalendat greke' si në rastin e Turqisë, ose të ecë fare shpejtë si në rastet e vendeve të Vishegradit apo të Vilniusit, sikundër mund të ballafaqohet me ulje-ngritje, ecje-ngecje, shpejtësime-ngadalësime si në rastin e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe Shqipërinë.

Në rastin e Shqipërisë, pa hyrë në sfidat e reformave të brendshme, disa të realizuara, disa të përgjysmuara dhe disa të tjera të pafilluara, diplomacia duket se është larg adoptimit të strukturës diplomatike mikse supranacionale dhe ndërqeveritare të BE-së. Për vetë traditën, diplomacia shqiptare është më e kulturuar dhe më e praktikuar me modelin sovranist Vestfalian dhe më pak me mënyrën Evropianiste. Ajo vepron më e sigurt në mënyrë unilaterale dhe bilaterale, pra në formatin kulturor dhe praktik tradicional sovranist. Prej më shumë se një shekulli Shqipëria ka ushtruar një diplomaci të tillë në familjen e kombeve.

Diplomacia shqiptare, për vetë traditën e saj, qysh prej pranimit në Lidhjen e Kombeve, mbas Luftës së Parë Botërore, e në vazhdimësi ka fituar një kulturë dhe praktikë edhe në formatin multilateral të diplomacisë. Ndonëse në diplomacinë multilaterale diplomacia shqiptare u tkurr gjatë

periudhës së Luftës së Ftohtë, duke kaluar në vetizolim, çka e ngurtësoi dimensionin multilaterale të saj, sërish multilateralizmi ka një farë baze në diplomacinë shqiptare. Kjo është arsyeja që në Lidhjen e Kombeve e më pas në Kombet e Bashkuara, diplomacia shqiptare ka qenë e pranishme e herë-herë ka treguar efikasitet dhe koherencë për situata apo ngjarje të caktuara ndërkombëtare.

Por, as diplomacia unilaterale, as diplomacia bilaterale, madje as ajo multilaterale veçmas nuk mund të jenë efikente dhe koherente në rastin e diplomacisë me Bashkimin Evropian. Unioni është entitet sui generis. Unioni është formuar si një format midis supranacionalizmit dhe ndërqeveritarizmit, ose midis federalizmit dhe sovranizmit, ose midis Evropianizmit dhe Vestfalizmit, ose midis tradicionalizmit dhe inovacionit.

E tillë është edhe diplomacia e Unionit. E, prandaj e tillë lypet të adoptohet edhe diplomacia e vendeve kandidatë, posaçërisht e Shqipërisë, e cila po përballë specifikisht me qasjet kontroverze diplomatike midis Vestfalianëve dhe Evropianëve, pa qenë efikente dhe koherente t'i afrojë ato në pikëtakime të njëjta qasjeje ndaj Shqipërisë. Ky është problem filozofie diplomatike, është problem strukturor diplomatik, është problem kulture dhe praktike diplomatike që, në tërësi, mund të thuhet është problem reformimi tërësor i shërbimit diplomatik shqiptar. Ky reformim nuk zëvendësohet vetëm me emërimin e një kryenegociatori, sado i kulturuar dhe me përvojë që të jetë ai.

Reformimi i shërbimit diplomatik shqiptar për adoptimin e strukturës së diplomacisë mikse Evropiane nuk do thotë që të heqim dorë nga diplomacia dhe praktika diplomatike tradicionale sovraniste Vestfaliane që e gëzojmë në rrafshet unilaterale, bilaterale dhe multilaterale prej afro një shekulli. Reformimi i diplomacisë shqiptare ka të bëjë me adoptimin e një filozofie, strukture, kulture dhe praktike, mekanizmash dhe teknikash mikse sui generis që i ka Bashkimi Evropian dhe që në thelb rrisin efikasitetin dhe kohezionin midis sovranizmit dhe evropianizmit në shërbimin diplomatik shqiptar në rrugën e integritit Evropian dhe më tej. Pa këtë adoptibilitet apo përputhshmëri diplomatike midis diplomacisë shqiptare me atë të Unionit, Shqipëria do ballafaqohet gjatë në procesin e integritit në Bashkimin Evropian e më tej në mirëfunksionimin e saj brenda Unionit.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Krasniqi: Feronikeli nuk e ka problem çështjen e pagave

Skuadra e Feronikelit nuk ka problem me financa dhe futbollistët paguhen me rregull, me përjashtim të ndonjë rasti derisa presidenti Naser Ramaj të vijë në Kosovë. "Vonimi i pagave nuk është çështje muajsh, por e tri apo katër ditëve", ka thënë Erlind Krasniqi, zëdhënës i Feronikelit



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 3 MARS** - Ditët e fundit janë shtuar zërat se skuadra e Feronikelit ka probleme me çështjen e pagave dhe se futbollistët nuk janë paguar nga muaji dhjetor i vitit të kaluar. Por, zëdhënësi i skuadrës së Feronikelit, Erlind Krasniqi, ka thënë të mërkurën për "Epokën e re" se lajmet për vonesat e pagave për futbollistët janë të pavërteta. Ai ka bërë me dije se vonesat e pagave janë vetëm çështje ditësh, por jo muajsh. "Ky lajm nuk qëndron. Kemi vonesa nganjëherë, për faktin se presidenti Ramaj jeton jashtë Kosovës, por për sa iu përket vonesave me muaj, nuk qëndron. E kemi buxhetin e paraparë për paga. E vetmja vonesë që mund të ndodhë është derisa të vijë presidenti ta nënshtrorë procedimin e pagave. Pra, vonimi i pagave nuk është

çështje muajsh, por e tri apo katër ditëve", ka thënë Krasniqi.

Disa futbollistë nuk janë duke u stërvitur kohët e fundit me Feronikelin, përfshirë Alban Pnishin dhe Bedri Grecën, por Krasniqi ka thënë se kjo është një çështje që i takon trajnerit. "Sa iu përket lojtarëve se kush stërvit, është çështje e trajnerit, ai e zgjedh ekipin e tij dhe e ka situatën në dorë. Lajme të tilla ka çdo muaj për secilën skuadër, kështu që nuk jemi të shqetësuar aspak", ka shtuar Krasniqi. Feronikeli, që ishte skuadër dominuese në futbollin e Kosovës dhe kampione e fituese e Kupës, këtë edicion nuk ka treguar stabilitet dhe aktualisht renditet në pozitën e gjashtë, me 26 pikë të grumbulluara, tri pikë më shumë se vendi që e dërgon në Ligën e Parë. Nga 22 ndeshjet e zhvilluara në kampionat, Feronikeli ka regjistruar 6 fitore, 9 barazime dhe 7 humbje.

**Dënohet Klodian Duro dhe portieri i Llapit**

Trajneri i Feronikelit, Klodian Duro, është dënuar nga Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës me 500 euro për shkak të sjelljeve jospportive në ndeshjen Feronikeli-Drenica. Ndërsa portieri i Llapit, Marjan Coriç, pas kartonit të kuq në ndeshjen kundër Ballkanit, dënohet me ndalesë loje për dy ndeshje zyrtare sipas radhës të organizuara nga FFK-ja. Ndërsa futbollisti i Prishtinës, Lumbardh Dellova, pezullohet pa të drejtë loje deri në kompletimin e lëndës. Ndërkohë presidentit të Trepçës '89, Abedin Zeka, i hapet procedura disiplinore deri në kompletimin e lëndës, lidhur me akuzat drejtuar Federatës së Futbollit. Në disiplinore është edhe skuadra e Llapit, e cila nuk iu ka përmbajtur kushteve kundër Covidit.

## SHKURT

### Të enjten dhe të premten mbahet turneu 'Adem Jashari' në futsall

Për nder të Epopesë së UÇK-së, nën përkujdesjen e FFK-së dhe të komisionit të futsallit, më 4 dhe 5 mars do të organizohet edicioni i 12-të i turneut tradicional ndërkombëtar "Adem Jashari". Për shkak të situatës me pandeminë, sivjet ky turne do të organizohet vetëm me ekipet vendore, e ku pjesëmarrëse do të jenë FC Prishtina, FC Prishtina 01, FC Drenica dhe FC Peja. Ndeshjet gjysmëfinale do të zhvillohen më 4 mars në orën 16:00 dhe në orën 18:00, kurse ndeshja finale do të zhvillohet më 5 mars në orën 18:00.

### Më 17 mars zhvillohet ndeshja Juventus - Napoli

Ndeshja Juventus - Napoli, e cila nuk ishte zhvilluar më 4 tetor për shkak të Covid-19, do të zhvillohet më 17 mars me fillim nga ora 18:45. "Njoftohet se ndeshja e Serisë A, Juventus - Napoli, e vlefshme për raundin e 3-të të fazës së parë, e pazhvilluar më 4 tetor 2020, do të luhet të mërkurën, më 17 mars 2021, duke filluar nga ora 18:45", thuhet në njoftimin e Serisë A.

### Apolonia ndali Partizanin, fitojnë Tirana dhe Kastrioti

Partizani, pas tri fitoresh radhazi, ndalet në Superiore. Skuadra e Ilir Dajës nuk mundi të shkonte më shumë se një barazim 1-1 në transfertën ndaj Apolonisë. Në minutën e 24-t, Haxhiu del mjaft mirë në krahun e majtë, pason në zonë, atje ku Hakaj, në tentativë për ta larguar topin, e dërgoi në rrjetën e tij. Partizani vuajti shumë për ta gjetur golin e barazimit që do të vinte në minutën e 76 me Cordeiron që devijon një top brenda zonës duke e dërguar në kuadrat. Tirana, pas Vllaznisë, mori një tjetër trepikësh të rëndësishëm në kampionat. Skuadra bardheblu mundi pastër 2-0 Bylisin. Behiratche në minutën e 40 dhe Ismailgeci në të 75-n ishin autorët e golave. Kastrioti fundosi Skënderbeun, duke marrë një fitore shumë të rëndësishme në Korçë. Golin e vetëm e realizoi Devid në minutën e 50.

## Astrit Selmani zgjedh Kosovën, pasi nuk ftohet nga Suedia

**PRISHTINË, 3 MARS** - Ylli i Hammarby, Astrit Selmani, është afër që t'i bashkohet Përfaqësueses së Kosovës në futboll gjatë këtij muaji. Selmani ka folur për "Fotbollskanalen". E ka pranuar interesimin e "dardanëve", por ka thënë se ende nuk ka marrë

asnjë ftesë zyrtare nga Kosova, mirëpo gjithçka është duke u bërë e qartë dhe se e ka rregulluar pasaportën. "Nuk kam pranuar ndonjë ftesë, por e kam rregulluar pasaportën. Është duke u bërë e qartë", ka thënë Selmani. "Po, kam dëgjuar. Do të shohim çfarë do të

ndodhë në ditët në vijim. Për ata që kanë dëgjuar është e drejtë që jam afër", ka shtuar ai. Në fund, i pyetur nëse është zgjedhja e vështirë: "Nuk ka asgjë që duhet të vendos, nuk ka pasur interesim nga Suedia", ka shtuar Selmani.



## Ferizaj ndërpret garat, rrezikon shuarjen

**FERIZAJ, 3 MARS** - FC Ferizaj është kapluar nga një krizë e madhe financiare. Ky klub ka njoftuar se për shkak të kësaj krize është i detyruar t'i ndërpresë garat në Ligën e Parë dhe seriozisht po

rrezikon shuarjen. "Krizë e madhe financiare që ka kapluar klubin tonë, gjendje e mjerueshme në klub, na detyron që ndeshjet e radhës mos t'i zhvillojmë fare dhe të largohemi nga garat. Është

mëkat i madh një qytet si Ferizaj, me biznesmenët më të fuqishëm në Kosovë, të mos përkrahët klubi i vetëm i qytetit me traditë 98-vjeçare. Lusim kryetarin e komunës, Agim Aliu, aksionarët që janë

në klub, t'i dalin në ndihmë klubit tonë, përndryshe ky është lajmërimi i fundit para shuarjes. Dikush duhet të japë përgjegjësi për këtë gjendje të rëndë", thuhet në njoftimin e Ferizajt.



## Lakersave nuk u mjafton LeBron, mposhten nga Phoenixi

**LOS ANGELES, 3 MARS** - Nikola Jokiq rezultoi protagonist absolut në fitoren e Denver Nuggetsit në parketin e Milwaukee Bucksit 97-128. "Triple-double" për "yllin" e skuadrës nga Colorado, e nënta që nga nisja e sezonit, e 50-ta në karrierë. Ndeshje e jashtëzakonshme për Jokiqin, që ishte më i miri mbi parket me plot 37 pikë, 11 asistim e 10 "rebounde". Një përballje që nuk u vu kurrë në diskutim nga Nuggetsit, me Bucksin gjithmonë në ndjekje të rivalit, por pa mundur ta arrinin atë. Jokiqi fitoi duelin e "yjeve" ndaj Giannis Antetokounmposit, 27 pikët e të cilit ishin shumë pak për ta shmangur humbjen e skuadrës që është e treta në



Konferencën e Lindjes, raporton "Supersport". Phoenix Suns iu imponua 114-104 Los Angeles Lakersit, duke i parakaluar kalifornianët në renditje në Konferencën e Perëndimit. Bëhet fjalë për suksesin e tetë në 10 sfidat e fundit për skuadrën nga Arizona, që po rezulton surpriza e këtij sezoni. Konfirmohet periudha negative e Lakersave, të cilëve nuk u mjaftuan 38 pikët e "mbretit" LeBron James. Më i miri për Suns rezultoi Sariq me 21 pikë. Bien Lakersi e të njëjtën

gjë bën edhe Clippersi. Në mungesë të Kawhi Leonardit, skuadra tjetër kaliforniane u mposht 117-112 nga Boston Celticsi, për të cilët ishte sukcesi i tretë radhazi. Kemba Walker la shenjën e tij me 24 pikë, duke qenë lideri i skuadrës së Bostonit, që duket se e ka kaluar krizën e muajve të fundit. Përballja u vendos në periodën e fundit, me Clippersi që u dorëzua edhe pse kishin shënuesin më të mirë të sfidës, Paul George, që realizoi në total 32 pikë.

### REZULTATET

Washington Wizards - Memphis Grizzlies	111-125
Boston Celtics - Los Angeles Clippers	117-112
Miami Heat - Atlanta Hawks	80-94
San Antonio Spurs - New York Knicks	119-93
Milwaukee Bucks - Denver Nuggets	97-128
Los Angeles Lakers - Phoenix Suns	104-114

## Suarez: Duam hakmarrje ndaj Realit



**MADRID, 3 MARS** - Sulmuesi i Atletico Madridit, Luis Suarez, e ka bërë të qartë se në derbin madrilen kërkon hakmarrje ndaj Real Madridit. Ish-sulmuesi i Barcelonës zbuloi se të gjithë lojtarët janë duke pritur përballjen ndaj skuadrës së Zinedine Zidanes. "Të gjitha ndeshjet kundër Real Madridit janë të veçanta, janë ato që dëshiron t'i luash dhe të demonstrosh se mund ta bësh. Shumë lojtarë e tregojnë veten

në këto ndeshje. Janë ndeshjet që t'i dëshiron t'i luash. Duhet të hakmerremi për ndeshjen e parë dhe të jemi gati të tregojmë se duam të qëndrojmë në krye", ka thënë Suarez. Më tutje, sulmuesi nga Uruguai zbuloi se objektivi i tij është t'i ndihmojë Atletico të fitojë La Ligan, trofe që nuk e ka fituar që nga viti 2014. "Jemi skuadër me shumë entuziazëm, dëshirë për të vazhduar, sukses dhe askush nuk do ta heq entuziazmin tonë

nga gara. Janë disa ditë të mbetura dhe do ta demonstrojmë nga çka jemi bërë. Si lojtar gjithmonë ke këto dëshira, të vish në një skuadër si Atletico që s'ka fituar tituj për një kohë të gjatë dhe t'i ndihmosh të fitojë", ka deklaruar Suarez. Atletico momentalisht është lider në La Liga me 58 pikë, pesë më shumë se Barcelona dhe Real Madridi, por "Los Rijoblanco" ka një ndeshje më pak të zhvilluar.

### SHKURT

#### Messi ka vendosur për të ardhmen

Lionel Messi duket se ka marrë vendimin për të ardhmen e tij dhe në fund të sezonit të njoftojë nëse do të qëndrojë apo jo te Barcelona. Ka shumë shënime për të ardhmen e sulmuesit. Për sa kohë që ylli argjentinas nuk ka nënshkruar një kontratë të re, thashethemet për largimin e tij nga skuadra katalanase po rriten. Pavarësisht nga disa shënime që qarkullojnë për të ardhmen e tij, Messi ka vendosur të flasë në fund të sezonit për atë që ai synon të bëjë. Sipas asaj që u tha në emisionin "El Larguero", Leo po pret zgjedhjet e 7 marsit për presidencën e Barcelonës por, sido që të jetë rezultati, Messi nuk do të njoftojë nëse do të qëndrojë apo jo te Barcelona, pasi ai ka vendosur ta thotë vendimin e tij në fund të këtij sezoni.

#### Alonso: Kam sakrifikuar shumë për rikthimin në pistë

Prezantimi i makinës Alpine, që këtë sezon te Formula 1 do ta pasojë trashëgiminë e markës Renault, është pritur me interes. Te kjo makinë (quhet A521) do të garojë një nga ikonat e Formula 1, spanjulli Fernando Alonso, që rikthehet pas dy vjetësh pushim. Dy herë kampioni i botës nuk ka qenë në prezantimin e njëvëndëshes Alpine. Gjithsesi, ai u shpreh: "Jam entuziast për rikthimin në Formula 1 dhe të jem pjesë e këtij kapitulli të ri të Alpine në sportin tonë. Kam punuar jashtëzakonisht shumë për ta përgatitur rikthimin tim, kam sakrifikuar shumë. Objektivi im është të sulmoj që në fillim të sezonit rivalët, më të mirët. E pranoj që kur ta ngas këtë makinë për herë të parë do të jetë emocionuese, por kjo do të kalojë shpejt. Kemi një ekip të fortë dhe jemi gati për këtë sezon të ri, që do të jetë kompetitiv", ka deklaruar Alonso.

#### Buffoni: Pensionohem pas katër muajsh ose më 2023

Portieri i Juventusit, Gianluigi Buffon, ka zbuluar se mund të vazhdojë të luajë deri në vitin 2023, edhe pse nuk e ka hedhur poshtë mundësinë që ta përfundojë karrierën e gjatë në fund të sezonit 2020/21, pra gjatë kësaj vere. Buffoni u kthye në Juventus në vitin 2019, pas një viti në Paris Saint-Germain, dhe në dy vjetët e fundit ka qenë zëvendësues i portierit të parë të Juves, Wojciech Szczesny. "Shikoni, në kokën time, vërtet ekziston një shenjë për ndalesën e fundit, maksimumi qershori i vitit 2023. Ai është maksimumi, vërtet, vërtet maksimumi. Por, mund të pensionohem pas katër muajve po ashtu", ka thënë Buffon.

#### Lacazette, pasardhës i Dzekos te Roma

Sulmuesi Edin Dzeko pritet të largohet nga Roma në afatin kalimtar të verës. Pasardhësi i tij në "Olimpico" parashikohet se do të jetë sulmuesi aktual i Arsenalit, Alexandre Lacazette. Sulmuesi francez ka kontratë me Arsenalin deri në vitin 2022, por dëshira e tij është të kalojë në një skuadër tjetër. Lacazette ka zhvilluar 119 ndeshje për Arsenalin dhe ka shënuar 46 gola.

#### Lamela, afër rinovimit me Tottenhamin

Fantazisti argjentinas Erik Lamela në sezonin e tij të tetë po luan me fanellën e Tottenhamit, por aventura e tij në Londër pritet të vijojë edhe për disa vjet të tjera. Futbollisti 28-vjeçar ka kontratë me londinezët deri në verën e 2022-shit, por trajneri Jose Mourinho ka mbetur mjaft i kënaqur me paraqitjet e tij dhe u ka kërkuar drejtuesve t'i rinovojnë bashkëpunimin. Mes palëve kanë nisur negociatat dhe kontrata e re pritet të zgjatet deri në verën e 2025-s, kur Lamela të jetë 33 vjeç dhe ta nisë planifikimin për t'u tërhequr nga futbolli. Për kartonin e argjentinasit, Tottenham pagoi rreth 35 milionë euro në arkat e Romës në verën e 2013-s, ndërsa që atëherë Lamela ka luajtur 244 ndeshje me "Spurs"-at dhe ka shënuar 36 gola.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

ÇMIMI: 5.99 €



**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

nga Moisiu deri te Kieślowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €



Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë





Shoqata Humanitare e Kosovës "Mëna Teresa"  
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"  
Humanitarna Dobrotvorna Udruženje Kosovo "Majka Teresa"  
10000 Prishtinë, Rr. ULPIANA U/1 po. Tel:00381 38 542864, Fax: 542869,  
Web site: www.mthteresa.org e-mail: mthteresa@yahoo.com

## CONTRACT AWARD NOTICE SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 03/03/2021

Procurement No	Entrepreneurship And Mentoring	002	2021	221
----------------	-----------------------------------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

### SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

#### I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 044-128-277	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-865	
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety.org	

### SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

#### II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: <b>Training on Entrepreneurship and Self Employment and Mentoring and Coaching for 240 new beneficiaries (Returnees and people at risk of illegal emigration)</b>
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)
<input type="checkbox"/> Services
Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities
II.1.4) Short description of the object of the contract <b>Training on Entrepreneurship and Self Employment and Mentoring and Coaching for 240 new beneficiaries (Returnees and people at risk of illegal emigration)</b>

#### II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

**93.000.000.-8**

#### II.1.6) Division into lots

YES

#### II.1.7) Contract value: 121,800.00

### SECTION III: PROCEDURE

#### III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

#### III.2) AWARD CRITERIA

Most Economically Advantageous tender

#### III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

#### SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award	03/03/2021
IV.2) Intended date of contract signing	15/03/2021
IV.3) Number of received tenders	4
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded	
Official name:	<b>D&amp;D Business Support Centre L.L.C</b>
Postal address:	10000 Prishtinë
Town: Prishtinë	Postal code: 10000
	Country: Kosovo
URL (if applicable):	
Contact point(s): Xhyljeta Luzha	Email: info@dd-bsc.com
Telephone: +38338748701	Fax: +38338748701

#### IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract **121,800.00 Euro**  
Responsive tender with lowest price: 121,800.00 Euro  
Responsive tender with highest price: 134,400.00 Euro

#### IV.6) The contract is likely to be subcontracted

No

### SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

#### V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract award notice.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Klinika Estetika Glow" SH.P.K. ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811482562 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Klinika Estetika Glow" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811482562, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Klinika Estetika Glow" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811482562, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Gëzim Bytyç shpall të humbur INDEX-in, e Fakultetit Juridik UP-Prishtinë, me nr. R-5601.
- ▶ Hyrije Mehmeti shpall të pavlefshme dëftesat dhe Diplomën e shkollës së mesme "Alaudin" Prishtinë.
- ▶ Egzone Qazim Muharremi shpall të pavlefshme Diplomën Bachelor për Banka, Financa dhe Kontabilitet në Universitetin e Prishtinës UP.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

